



## **MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË**

në mes të

**Kolegjit UNI –Universum International College Powered by Arizona State University**

dhe

**Qendra për Edukim të Hershëm**

**Learning Tree Sh.p.k**

### **I. Qëllimi i Memorandumit**

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

### **II. Fushëveprimtaria**

Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, Qendra për Edukim të Hershëm- Learning Tree në Prishtinë do t'u mundësoj studentëve të Programeve Shëndetësore të Kolegjit UNI përfundimin e punës praktike në qender, me kohëzgjatje të dakorduar në mes të palëve.

1. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji UNI do t'u mundësoj studentëve ndjekjen me rregull të orarit të praktikës, të përcaktuar nga përgjegjësi i caktuar nga Qendra për Edukim të Hershëm- Learning Tree.

2. Rekomandimi i kandidatëve për punë praktike do të bëhet nga Kolegji UNI, përmes një komunikimi të rregullt dhe transparent me menaxhmentin e Qendra për Edukim të Hershëm-Learning Tree.
4. Kolegji UNI do të siguroj që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.


### III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni


1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjelltë me besueshmëri të plotë;
3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.
4. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është pa afat kohor.
5. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtinë, më: 04.06.2024


### PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji UNI – Universum

  
Uran Raci  
Zëvendës President Ekzekutiv



Qendra për Edukim të Hershëm  
Learning Tree

  
Donika Shabani-Sinani  
Drejtor Ekzekutiv

